

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-532/2021	Data: Datum: 30.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin “Ndërtimi i Urave në Shushicë, Kovragë dhe Kaliqan”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6257-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-052-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i Urave në Shushicë, Kovragë dhe Kaliqan”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6257-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-052-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbimeve Publike, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
- 1.3. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i Urave në Shushicë, Kovragë dhe Kaliqan”; me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-531/021	Data: Datum: 30.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.89/2021 të datës 29.09.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi që i propozon Kryetarit të miraton kërkesën Nr.09-320-37195 të datës 06.09.2021 të parashtruar nga Avni Haxhiu nga fsh Bellopojë, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga temperatura i kanë ngordhur lopët dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-37195 e datës 06.09.2021 të parashtruar nga Avni Haxhiu për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga temperatura e lartë që i ka ngordhur 10 krerë lopë dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **2,000.00€ (dymijë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Avni Haxhiu, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Avni Haxhiu, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-37195 të datës 06.09.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga temperatura e lartë që i ka shkaktuar ngordhjen e 10 krerë lopë qumështore.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar temperatura e lartë dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni pas shqyrtimit të procesverbalit të Ambulantes Veterinare i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe sipas AUV shkaktaret e ngordhjes se lopëve mbeten te paqarta dhe ka vlerësuar dëmin e fermerit në shumë prej **16,000.00€ (gjashhtëmbëdhjetë mijë euro)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahët fermeri në shumë prej **2,000.00€ (dymijë euro)**.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë 10 krerë lopë qumështore.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Avni Haxhiu, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
Lulzim SHOSHI

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-530/2021	Data: Datum: 30.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), për shkaqe subjektive të Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim cakton Koordinatorin për mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHET:** Koordinator i projekteve të D.E.ZH **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- I lartpërmenduri për realizimin e projekteve të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim do të bashkëpunoj me menaxheret e projekteve dhe me kompaninë mbikëqyrëse; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e projekteve gjatë implementimit të tyre; me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së realizimit të kontratave si dhe do t'i kryejnë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij Vendimi.
- Koordinatori ka filluar ti mbikëqyr realizimin e projekteve të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim nga muaj gusht dhe vazhdon me mbikëqyrje deri në marrjen e një Vendimi tjetër.
- Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij dhe fillon të zbatohet nga Koordinatorin i projekteve.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Hekuran Rugova**, Menaxheret e projekteve, Kompania mbikëqyrëse, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-528/2021	Data: Datum: 30.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-32509, të datës 13.08.2021, e parashtruar nga z.Haki Murataj, nga fsh.Suhogerllë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e prindit të tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-32509, të datës 13.08.2021, e parashtruar nga z.Haki Murataj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Haki Murataj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Haki Murataj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-32509, të datës 13.08.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim të prindit. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Sofije Murataj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Haki Murataj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Haki Murataj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-527/021	Data: Datum: 28.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.76/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi që i propozon Kryetarit të miraton kërkesën Nr.09-320-8241 të datës 03.03.2020 të parashtruar nga Shefqet Lipaj nga fsh. Studenicë, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-8241 e datës 03.03.2020 e parashtruar nga Shefqet Lipaj, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri që e ka djegur fermën e pulave që 1,765 pula kanë ngordhur dhe i ndahen **2.000.00€ (dymijë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Shefqet Lipaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shefqet Lipaj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-8241 të datës 03.03.2020, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri që është djegur ferma e pulave dhe i kanë ngordhur 1,765 pula.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe në procesverbal ka vlerësuar dëmin që fermerit zjarri i ka shkaktuar dëme në fermën e pulave i kanë ngordhur 1,765 pula në shumë prej **8.825.00€ (tetë mijë e tetëqind e njëzet e pesë euro)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahët fermeri në shumë prej ndahen **2.000.00€ (dymijë euro).**

I përmenduri nuk ka mundësi që me mjete vetanake ti blejë pulat.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.


Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: **Shefqet Lipaj**, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
Lulzim SHOSHI




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-526/021	Data: Datum: 28.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-39768 të datës 20.09.2021 e parashtruar nga Kimeta Destanović nga fsh. Dobrusha, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërim, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-553-39768 e datës 20.09.2021 e parashtruar nga Kimeta Destanović, për ofrim të ndihmës financiare për shërim, i ndahen 300.00€(treqind euro) nga kategoria ekonomike subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Kimeta Destanović, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Kimeta Destanović, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-39768 të datës 20.09.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se fletëlëshim me epikrizë i repartit Internistik në Spitalin Regjional Pejë shihet se Kimetja vuan nga HTA dhe nga diabeti dhe ka nevojë për trajtim të mëtutjeshëm si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë kontrollet mjekësore të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Kimeta Destanović, Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 525/2020	Data: Datum: 28.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.10-553-40127 të datës 21.09.2021 e parashtruar nga Senada Luković nga fshati Banjë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për shërim, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-553-40127 e datës 21.09.2021, e parashtruar nga Senada Luković, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë, i ndahen 300.00€ (treqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Senada Luković, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Senada Luković, ka parashtruar kërkesën Nr.10-553-40127 të datës 21.09.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raporti i mjekut në Spitalin Istanbul Medicine shihet se Senada është e sëmurë nga veshka e majtë e cila është e hekur kirurgjikisht dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është i kushtueshëm.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë së nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Senada Luković, Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.Br.523/2021	Data: Datum: 28.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale nenit 38 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Paruniversitar në Republikën e Kosovës dhe nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të zv.drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo –Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimet ,Përfundimit të Kontratës dhe Emërimet e Përkohshme merre këtë:

V E N D I M

- I. Znj.Jehonë Visoqi nga Istogut, mësimdhënëse pranë shkollës “Mehmet Akifi” në Shushicë e kualifikuar në programin e Matematikës dhe Informatikës caktohet në detyrat e punës së ushtrueses së detyrës së drejtorit në SHFMU “Mehmet Akifi” në Shushicë.
- II. Sipas këtij vendimi, detyrat e drejtorit e përmendura do ti kryej me kompetenca të plota në pajtim me Ligjet në fuqi deri në përfundim të procedurave të konkursit për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të këtij institucioni arsimor.
- III. Paga bazë 495.30 euro. Kodi i titullit DIR-7.8
- IV. Me këtë vendim njoftohen: Shkolla “Mehmet Akifi” në Shushicë, mësimdhënësjat e deritanishme ,Drejtoria e Arsimit dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës së Istogut.



Kryetari i Komunës
z/Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.522/021	Data: 28.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit 05.Nr.500/2021 të datës 27.09.2021, për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Xhemajl Zogaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Fizikës në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.500/2021 e datës 27.09.2021, e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Xhemajl Zogaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Fizikës në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 15.10.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Xhemajl Zogaj, t'ia bëjë pagesën, e 3 (tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Xhemajl Zogaj, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-521/020	Data: Datum: 27.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-352-2630 të datës 21.01.2021, të parashtruar nga Nuriye Mujajngafsh. Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për ndërtimin e shtëpisë dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-352-2630 e datës 21.01.2021 e parashtruar nga Nuriye Mujaj për përkrahje financiare për ndërtimin e shtëpisë për përkrahje me mjete financiare në shumë prej **1,000.00€ (njëmijë euro)**, për blerjen e materialit ndërtimor për shtëpi nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Nuriye Mujaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe Kryetari i Komunës
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Nuriye Mujaj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-352-2630 e datës 21.01.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për ndërtimin e shtëpisë së banimit dhe përkrahje me material ndërtimor.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit dhe përkrahje me material ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë së banimit, e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka vlerësuar që të përkrahje me material ndërtimor për shtëpi dhe ka konstatuar se është e nevojshme të ndihmohet me mjete financiare në shumë prej **1,000.00€ (njëmijë euro)**, për ndërtimin e shtëpisë.

E lartpërmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike nuk ka asnjë burim të të arshurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanaketë blejë materialin ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë së banimit dhe për këtë arsye i ndihmohet me mjete financiare.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Nuriye Mujaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës

Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-520/2021	Data: Datum: 27.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), për pranim dorëzimin e projektit: "Muzeu i Arsimit në Kosovë-fshati Uçë" nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për pranim dorëzimin e projektit: "Muzeu i Arsimit në Kosovë-fshati Uçë" nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe në komision caktohen:

- 1.1. Qefsere Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, Kryesuese e komisionit;
- 1.2. Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. Naim Sadriu**, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim , anëtar.

2. Komisioni ka për obligim që të bëjë pranim–dorëzimin e projektit: "Muzeu i Arsimit në Kosovë-fshati Uçë" nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të lidhur me pranimin-dorëzimin e projektit të lartcekur.

3. Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të mbikëqyrë realizimin e projektit të lartcekur siç është me projektin e pranuar; të bashkëpunoj me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe të mbikëqyr punë kryerësin i cili obligohet të përfundoj projektin ashtu si është në projektin e pranuar nga Komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, i dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Me kopje të ketij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-519/021	Data: Datum: 27.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-352-26281 të datës 13.07.2021, të parashtruar nga Muharrem Ukaj, ngafsh. Baicë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-352-26281 e datës 13.07.2021, të parashtruar nga Muharrem Ukaj, për përkrahje financiare për blerjen e derës së hyrjes së shtëpisë dhe i ndahen **500.00€ (pesëqindeuro)**, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Muharrem Ukaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe Kryetari i Komunës
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Muharrem Ukaj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-352-26281 të datës 13.07.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare përfinanciare për blerjen e derës së hyrjes së shtëpisë e cila i është shkatërruar nga vjetërsia dhe çdo erë që frynë rrezikon të bie.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit dhe nevojës për ti ndihmuar përblerjen e derës së hyrjes në shtëpi dhe konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisionika vlerësuar se duhet të përkrahët me mjete financiare në shumë prej 500.00€ (pesëqindeuro) për blerjen e derës së hyrjes në shtëpi.

I lartëpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko jeton nga puna në bujqësi dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanaketë blejë derën e shtëpisë.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë etij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Muharrem Ukaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-518/2021	Data: Datum: 27.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-37102, të datës 06.09.2021, e parashtruar nga z.Hamdi Rraci, nga fsh. Banjë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes së tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-37102, të datës 06.09.2021, e parashtruar nga z.Hamdi Rraci, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të bashkëshortes, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 200€(dyqindë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Hamdi Rraci, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Hamdi Rraci, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-37102, të datës 06.09.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e bashkëshortes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj. Aze Kajtažaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Hamdi Rraci, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Hamdi Rraci, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-516/2021	Data: Datum: 24.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Betonimi i Kanalit të Ujitjes të Varrezat e Dëshmoreve Vrellë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5992-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-049-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Betonimi i Kanalit të Ujitjes të Varrezat e Dëshmoreve Vrellë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5992-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-049-521, dhe në komision caktohen:

- 1.1 Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryesues i Komisionit;
- 1.2 Valbona Kaliqanaj**, Zyrtare e Lartë për Pemëtarë, anëtare dhe
- 1.3 Dukagjin Hoxhaj** Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Betonimi i Kanalit të Ujitjes të Varrezat e Dëshmoreve Vrellë” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-514/2021	Data: Datum: 23.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-25092, të datës 06.07.2021, e parashtruar nga z.Visar Haxhijaj, nga Istogu, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes se tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-25092, të datës 06.07.2021, e parashtruar nga z.Visar Haxhijaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të bashkëshortes, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 400€(katërqind euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Kaltrina Dakaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësië.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Visar Haxhijaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-25092, të datës 06.07.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e bashkëshortes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj. z.Kaltrina Dakaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e znj.Kaltrina Dakaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Visar Haxhijaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-513/2021	Data: Datum: 23.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoi kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Veriq- Rakosh dhe anasjelltas”; Lot2 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Mojstir-Sine- Istog dhe anasjelltas” Lot3 “Transporti i nxënësve ne Relacionin Padalisht-Rakosh dhe anasjelltas”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5535-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-032R-221, nxjerr:

V E N D I M

- 1. FORMOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Veriq- Rakosh dhe anasjelltas”; Lot2 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Mojstir-Sine- Istog dhe anasjelltas”; Lot3 “Transporti i nxënësve ne Relacionin Padalisht-Rakosh dhe anasjelltas” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5535-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-032R-221 dhe në komision caktohen:

1.1. Naser Nimanaj, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;

1.2. Blerim Bujupi, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe

1.3. Naim Sadriu, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Veriq- Rakosh dhe anasjelltas”; Lot2 “Transporti i Nxënësve në Relacionin Mojstir-Sine-Istog dhe anasjelltas”; Lot3 “Transporti i nxënësve ne Relacionin Padalisht-Rakosh dhe anasjelltas”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik qe kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-512/2021	Data: Datum: 23.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-13280, të datës 01.07.2021, të parashtruar nga z.Sokol Blakaj, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-24296, të datës 01.07.2021, e parashtruar nga z.Sokol Blakaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore (Kimioterapisë) dhe i lejohen 100 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Sokol Blakaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Sokol Blakaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-24296, të datës 01.07.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Emine Zeqiraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Sokol Blakaj,Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-509/2021	Data: Datum: 22.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 "Asfaltimi i Rugës në Studenicë deri të Varrezat"; Lot2 "Asfaltimi i Rugës Lagja Mehaj- dhe vendosja e Ndriçimit Publik"; Lot3 "Asfaltimi i Rugës Lagja Haxhijaj"; Lot4 "Hapja e Kanalit-vendosja e gypit për uji të pijes Carrallukë"; Lot5 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në lagjen Habib Osmanaj"; Lot6 "Ndërtimi i Kanalizimit Fekale në Lagjen Abazaj" Lot7 "Asfaltimi i Rugës në Lagjen Kurtaj"; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6010-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-050-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 "Asfaltimi i Rugës në Studenicë deri të Varrezat"; Lot2 "Asfaltimi i Rugës Lagja Mehaj- dhe vendosja e Ndriçimit Publik"; Lot3 "Asfaltimi i Rugës Lagja Haxhijaj"; Lot4 "Hapja e Kanalit-vendosja e gypit për uji të pijes Carrallukë"; Lot5 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në lagjen Habib Osmanaj"; Lot6 "Ndërtimi i Kanalizimit Fekale në Lagjen Abazaj" Lot7 "Asfaltimi i Rugës në Lagjen Kurtaj"; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6010-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-050-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Shahe Ferizaj**, Zyrtare e të Hyrave Finaciare, anëtare dhe
- 1.3. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për Partneritet Publiko Privat, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet Lot1 "Asfaltimi i Rugës në Studenicë deri të Varrezat"; Lot2 "Asfaltimi i Rugës Lagja Mehaj- dhe vendosja e Ndriçimit Publik"; Lot3 "Asfaltimi i Rugës Lagja Haxhijaj"; Lot4 "Hapja e Kanalit-vendosja e gypit për uji të pijes Carrallukë"; Lot5 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në lagjen Habib Osmanaj"; Lot6 "Ndërtimi i Kanalizimit Fekale në Lagjen Abazaj" Lot7 "Asfaltimi i Rugës në Lagjen Kurtaj", me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do të kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-508/2021	Data: Datum: 22.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.09-320-32654 të datës 13.08.2021, të parashtruar nga Gjevdet Metaj, nga fsh. Bellopojë, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-32654 e datës 13.08.2021 e parashtruar nga Gjevdet Metaj, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri respektivisht është shkaktuar nga deponia e mbeturinave në Tuçep dhe ky zjarr ka mbërri deri në fshatin Shushicë e ulët e që fermerit i ka dëmtuar 1. ha pemishte të mbjellë me kumbulla dhe i ndahen **3,450.80€ (tremijë e katërqindpesëdhjetë euro e tetëdhjetë cent)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Gjevdet Metaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Gjevdet Metaj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-32654 të datës 13.08.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri respektivisht është shkaktuar nga deponia e mbeturinave në Tuçep dhe ky zjarr ka mbërri në fshatin Shushicë e ulët e që fermerit i ka dëmtuar 1. ha pemishte të mbjellë me kumbulla. Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka ndaluar në vendin e ngjarjes dhe me procesverbal ka vlerësuar dëmin e shkaktuar nga zjarri si pasojë e djegies së mbeturinave në Tuçep në shumë prej **3,450.80€ (tremijë e katërqindpesëdhjetë euro e tetëdhjetë cent)**

Nga shkresat e lendes shihet se Gjevdetit ju kanë dëmtuar 1. ha pemishte të mbjellë me kumbull, i cili është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë punimin e tokës të mbjellë me kumbullat, dhe për këtë arsye i ndihmohet me mjete financiare.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Gjevdet Metaj, Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-507/021	Data: Datum: 22.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-39231, të datës 16.09.2021, e parashtruar nga Emina Coković nga fsh. Kovragë Komuna e Istogu për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-babës (Fehim Coković) i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-39231, të datës 16.09.2021, e parashtruar nga Emina Coković, Zyrtare për Buxhet dhe Financa2, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së babës (Fehim Coković) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent)) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Emina Coković, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Emina Coković, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-506/2021	Data: Datum: 22.09.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc”; Lot2 “Asfaltimi i rrugës Arif Ademi- Banjë”; Lot3 “Asfaltimi i rrugës Dobrushe-Lubove”; Lot4 “Ndërtimi i rrugës Rozhja në Banjë”; Lot5 “Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Lagja Kajtažaj Dragolevc”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5821-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-048-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc”; Lot2 “Asfaltimi i rrugës Arif Ademi- Banjë”; Lot3 “Asfaltimi i rrugës Dobrushe-Lubove”; Lot4 “Ndërtimi i rrugës Rozhja në Banjë”; Lot5 “Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Lagja Kajtažaj Dragolevc”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-5821-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-048-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Genc Ademaj,** Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për Partneritet Publiko Privát, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
- 1.3. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc”; Lot2 “Asfaltimi i rrugës Arif Ademi- Banjë”; Lot3 “Asfaltimi i rrugës Dobrushe-Lubove”; Lot4 “Ndërtimi i rrugës Rozhja në Banjë”; Lot5 “Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Lagja Kajtažaj Dragolevc” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-504/021	Data: Datum: 21.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.76/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi që i propozon Kryetarit të miraton kërkesën Nr.09-320-24347 të datës 01.07.2021, të parashtruar nga Azllan Veselaj nga fsh. Suhogerllë, Komuna e Istogut, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-24347 e datës 01.07.2021 e parashtruar nga Azllan Veselaj për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga rryma që ju ka djegur stalla e lopëve dhe 800 duaj sanë nga zjarri, i ndahen **1,000.00€ (një mijë e euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Azllan Veselaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Azllan Veselaj, ka parashtruar kërkesë Nr.09-320-24347 të datës 01.07.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar rryma që ju ka djegur stalla e lopëve dhe 800 duaj sanë. Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka ndalur në vendin e ngjarjes dhe me procesverbal ka vlerësuar dëmin e shkaktuar nga zjarri si pasoj e rrymës në shumë prej **5,448.55€ (pesë mijë e katërqind e katër dhjetë tetë euro e pesëdhjetë e pese cent)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahet fermeri në shumë prej **1,000.00€ (një mijë euro)**.

Nga shkresat e lendes shihet se Azllanit ju kanë djegur stalla e lopëve dhe 800 duaj sanë që janë djegur si pasoj e rrymës. I lartëpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e ushqimit të bagëtive dhe të ndërtojë stallën e lopëve.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen Azllan Veselaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
Lulzim SHOSHI

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-503/2021	Data: Datum: 21.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-29446 të datës 30.07.2021 të parashtruar nga Shpetim Podrimaj nga Istogu për përkrahje financiare për realizimin e projektit “Oldshookstreffen”, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-29446 e datës 30.07.2021, e parashtruar nga Shpetim Podrimaj për përkrahje financiare për realizimin e projektit “Oldshookstreffen” për ekspozimin e veturave të vjetra dhe i ndahen mjetet financiare në shumë prej **900.00€ (nëntëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere e Zyrës së Kryetarit .
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Shpetim Podrimaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shpëtim Podrimaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-29446 të datës 30.07.2021, për përkrahje financiare për realizimin e projektit “Oldshookstreffen” për ekspozimin e veturave të vjetra në qytetin e Istogut. Kryetari shqyrtoi kërkesën e Shpëtim Podrimaj, dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe i miraton. Duke parë rendësin e realizimit të këtij projekti për ekspozimin e veturave të vjetra në qytetin e Istogut i cili ka kërkuar të përkrahet me mjete financiare në shumë prej 1,000.00(një mijë euro) dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet me **900.00€ (nëntëqind euro)** për realizimin e projektit në fjalë. Në planin e programit buxhetor të është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t’i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Shpëtim Podrimaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-502/021	Data: Datum: 21.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.76/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi që i propozon Kryetarit të miraton kërkesën Nr.09-320-23676 të datës 28.06.2021, të parashtruar nga Arben Alimetaj, nga fsh. Muzhevinë, Komuna e Istogut, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-23676 e datës 28.06.2021, e parashtruar nga Arben Alimetaj, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga rryma që ju ka djegur strehimorja e ushqimit të kafshëve, kulmi konstruksioni nga druri i mbuluar me tjegulla, ushqimi i bagëtitve, grurë, traktori i markës Zetor, rimorkio dhe mulliri trefazor për përgatitjen e ushqimit të shkaktuar nga zjarri dhe i ndahen **1,000.00€ (një mijë e euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Arben Metaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Arben Alimetaj, ka parashtruar Nr.09-320-23676 të datës 28.06.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga rryma që ju ka djegur strehimorja e ushqimit të kafshëve, kulmi konstruksioni nga druri i mbuluar me tjegulla, ushqimi i bagëtitve, grurë, traktori i markës Zetor, rimorkio dhe mulliri trefazor për përgatitjen e ushqimit.

Kryetari shqyrtoj propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit në shumë prej **5,675.00€ (pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë euro)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahet fermeri në shumë prej **1,000.00€ (një mijë euro)**.

Nga shkresat e lendes shihet se Arbenit ju kanë djegur strehimorja e ushqimit të kafshëve, kulmi konstruksioni nga druri i mbuluar me tjegulla, ushqimi i bagëtitve, grurë, traktori i markës Zetor, rimorkio dhe mulliri trefazor për përgatitjen e ushqimit që janë djegur si pasojë e rrymës.

I lartpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e ushqimit të bagëtitve dhe pajisjet bujqësore.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Arben Alimetaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
Lulzim SHOSHI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-501/021	Data: Datum: 21.09.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.76/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi që i propozon Kryetarit të miraton kërkesën Nr.09-320-31009 të datës 09.08.2021, të parashtruar nga Fidan Metaj, nga fsh. Shushicë e ulët, Komuna e Istogut, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-31009 e datës 09.08.2021, të parashtruar nga Fidan Metaj për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri i deponisë së mbeturinave ne Tuçep, që i është djegur stalla e bagëtive, 1,500 duaj sane, 500 duaj kashte, 50 rrotaball (ushqim ne folje najloni) dhe 10000 kg grurë, i ndahen **1,000.00€ (një mijë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Fidan Metaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Fidan Metaj, ka parashtruar Nr.09-320-31009 të datës 09.08.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri i deponisë së mbeturinave ne Tuçep që i është djegur stalla e bagëtive, 1,500 duaj sane, 500 duaj kashte, 50 rrotaball (ushqim ne folje najloni) dhe 10000 kg grurë.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit në shumë prej **10,428.55€ (dhjetë mijë e katërqind e njëzet e tetë euro e pesëdhjetepesë cent)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahet fermeri në shumë prej **1,000.00€ (një mijë euro)**.

Nga shkresat e lendes shihet se Fidanit ju kanë djegur stalla e bagëtive, 1,500 duaj sanë, 500 duaj kashte, 50 rrotoballa (ushqim ne folje najloni) dhe 10000 kg grurë.

I lartëpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e gjitha atyre që u cekën me lartë.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Fidan Metaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
Lulzim SHOSHI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-500/2021	Data: Datum: 21.09.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-40014, të datës 21.09.2021, e parashtruar nga z.Niman Çapkunaj, nga Istogu, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes se tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-40014, të datës 21.09.2021, e parashtruar nga z.Niman Çapkunaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të bashkëshortes, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqind e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Niman Çapkunaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Niman Çapkunaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-6938, të datës 23.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e bashkëshortes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj. z.Serbeza Çapkunaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaft të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Niman Çapkunaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Niman Çapkunaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-499/2021	Data: Datum: 21.09.2021	

